



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
LOGO E INSTITUCIONIT**

Adresa: _____

Tel. _____

URDHËR I BRENDSHËM

Nr. __, datë _____.2023

**“Për ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes
së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”**

Në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar (Kreu 2, neni 5 dhe neni 37, të ligjit në fjalë), ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (ky ligj vetëm për njësitë e qeverisjes vendore), ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, (ky ligj vetëm për institucionet e administratës shtetërore), (Ministritë e linjës), Kodit Zgjedhor të RSH dhe Vendimit nr. 9/2020 të KQZ “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”,

KONSTATOJ:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me shkresën nr. __ prot., datë _____.____,2023 “Mbi monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor”, ka udhëzuar njësinë përgjegjëse për të ngritur grupin e monitorimit, me qëllim sigurimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil dhe vijueshmërinë normale të punës, së trupës së nëpunësve civilë, të pa ndikuar nga procesi zgjedhor, gjatë veprimtarisë së tyre.

Në këto rrethana, mbështetur në bazën ligjore të sipërpërmendur,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e Grupit të Punës për monitorimin e sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore me këtë përbërje:
 1. Emër Mbiemër (pozicioni i punës) Kryetar
 2. Emër Mbiemër (pozicioni i punës) Anëtar
 3. Emër Mbiemër (pozicioni i punës) Anëtar

2. Koordinatorin e grupit që do të komunikojë me palët e interesuara në këtë proces dhe me Komisionerin për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil do të jetë Z./Znj. **Emër Mbiemër (pozicioni i punës)**.
3. Grupi i punës të hartojë deri në datën **15.02.2023** rregulloren e brendshme të veprimtarisë së tij dhe të përcaktojë rregullime specifike për nëpunësit civilë gjatë periudhës zgjedhore, të cilën do ta paraqesë për miratim tek titullari i institucionit *(sipas tipologjisë së institucionit kryetari i njësive të qeverisjes vendore, ose Sekretari i Përgjithshëm në ministritë e linjës)*.
4. Me këtë Urdhër dhe Rregulloren e Brendshme të grupit të punës, të njihen të gjithë nëpunësit civilë dhe të informohet Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, brenda datës **20.02.2023**, duke i vënë në dispozicion një kopje të praktikës.
5. Me zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Grupi i punës dhe Zyra e Arkiv-Protokollit.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Nënshkrimi